



Republika e Kosovës / Republic of Kosova  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



3990  
01/Nr.\_\_\_\_/2024  
Data:22.05.2024

### PROCESVERBAL I KUVENDIT TË KOMUNËS

Procesverbali nga mbledhja e katërt -IV- e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 30.04.2023 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës. Të pranishëm ishin: **Mehmet Ballazhi** (Kryetar i Komunës), **Majlinda Kaloshi** (Drejtoreshë për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm), **Lindita Ballazhi** (Drejtoresh për Buxhet dhe Financa), **Arsim Dernjani** (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), **Nexhmedin Daci** (Drejtor për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Kimete Kuka –Hasallari** (Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), **Natyra Kalisi** (Drejtoresh e Administratës), **Abduraman Bushi** (Drejtor për Bujqësi , Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Hisni Luri** (Drejtor për Arsim), **Arbenita Bajramaliu** (Drejtoresh për Kulturë, Rini dhe Sport), **Bashkim Sopa** (Zyrtarë për Transparencë).

#### RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Statuti i QKMF-së –Hani i Elezit.
3. Raporti financiar për periudhën Janar – Mars 2024.
4. Informatë për ndarjen e bursave.
5. Raporti financiar për periudhën Janar – Mars 2024 i N.P.L “Pastrimi” sh.a.
6. Të ndryshme.

**Kryesuesi** thekson:-për pikat e rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim , rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

## 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

**Kryesuesi** thekson:- a keni ndonjë vërejtje rreth procesverbalit, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

### U MIRATUAR PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

#### 1. Statuti i QKMF-së –Hani i Elezit.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Kimete Kuka –Hasallari** thekson:- është mbajtur diskutimi publik dhe nuk ka pasur ndonjë propozim dhe diçka të veçantë nuk kam.

**Sherif Berisha** thekson:- sa i përket dëgjimit publik ka qenë një staf prej QKMF-së dhe një pjesë e zyrtarëve komunal kështu që nuk ka pasur njoftim të mirë për dëgjim publik . Ju keni pranuar formën unike në nivel të Kosovës të këtij statusi për miratim por mirë do të ishte te procedura për emërim të drejtorit që është mjekë i mjekësisë familjare, është mirë që në statut të jetë të jesh i punësuar në QKMF, me qenë se praktika po tregon se në QKMF mund të bëhesh drejtor pa qenë fare specialistë i mjekësisë familjare dhe nga marrja e mandatit s'keni pasur vullnet për çështjen e specialistit për me angazhuar. A keni aktualisht shef të mjekësisë familjare. A keni koordinatorë të cilësisë. A keni planifikuar që QKMF-ja të ketë kardiologë në Han të Elezit. A keni menduar ndonjë herë për hapjen e sektorit të maternitetit në Han të Elezit aktualisht çfarë konsulent ka në QKMF dhe a planifikoni që të ketë shërbime të reja në Komunën tonë.

**Malik Berisha** thekson:-a mundesh ndryshimet me statusin e më hershëm që e kemi pasur na interesojnë pak a shumë.

**Kimete Kuka –Hasallari** thekson:- konkursin për specialist të mjekësisë familjare që nga fillimi i mandatit e kemi shpallur por fatkeqësisht nuk ka të interesuar dhe për këtë çështje kam diskutuar me regjionin e Ferizajt që të paktën me na ndihmuar në këtë aspekt edhe për kundër apelit drejtorët që kanë bërë te mjekët por nuk kanë pasur interesim. Shefi i mjekësisë familjare është në ato qendra ku është numri i të punësuarve mbi 100 persona te na realisht i kemi vetëm 32 dhe për atë arsye nuk e kemi të drejtën me pasur shef të mjekësisë familjare, ndërsa koordinatorë e cilësisë është.

**Sherif Berisha** thekson:- pavarësisht përgjigjeve të drejtoreshës unë mundem me ju përgëzuar për ambulancën që është marr prej kompanisë Sharrcem dhe pata fatin që të jem prezentë por pasdite e njëjta është shtyerë për me u dhezur që diçka nuk është në rregull.

**Kimete Kuka –Hasallari** thekson:- nuk jam në dioni për këtë problem por nëse është diçka në defekt është automjet i ri dhe duhet të parashihet edhe për servise. Sa i përket ndryshimeve me statutin e vjetër nuk është që ka shumë pika drejtori me statut të vjetër ka qenë përveç specialistit të mjekësisë familjare të drejtë ka pasur edhe specialistë të tjerë e që ka qenë në kundërshtim me udhëzimin administrativ sepse udhëzimi e përcakton që drejtori duhet të jetë specialistë i mjekësisë familjar. Përveç trupave të tjerë që e përbëjnë kemi edhe këshillin e pacientëve që duhet të formohet.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- këtu bëhet fjalë për statutin e QKMF-së dhe nëse keni diçka konkret që mundeni me ndihmuar këtë statut për punët e më vonshme në QKMF atëherë këtu besoj që duhet të jetë fokusi, ndërsa çështja e specialistëve është në kuadër të raportit të punës apo te pika e rendit të punës të ndryshme

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim rezultati i votimit ishte njëzëri prezent ishin 14 këshilltarë.

### U MIRATU STATUTI I QKMF-SË HANI I ELEZIT



### 3.Raporti financiar për periudhën Janar – Mars 2024.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Lindita Ballazhi** thekson:- buxheti i komunës së Hanit të Elezit i ndarë sipas Ligjit me numër 08/L-260 mbi ndarjet buxhetore të Republikës së Kosovës për vitin 2024 është në lartësi prej 3,349,278.00 €, ndërsa buxheti përfundimtarë është në shumë 3,811,674,42 €, ku në këtë shumë përfshihen : shuma e ndarë nga Grantet Qeveritare në shumë prej 3,074,901.87 €, projeksioni i të hyrave vetanake komunale në shumë prej 274,376.00 €, donacioni nga Unioni Evropian për projektin dy vjeçar “A smart sistem for Early Floods Detection and Easte Monitoring in the Lepenc River Basin në shumë prej 446,352.85 €. Pjesa e mbetur e donacionit nga Qeveria Japoneze për projektin ‘Ndërtimi i aneksit për për këmbësorë në Urën e Seçishts “ në shumë prej 15,923.01 €. Mjete të mbetura nga grantet të cilat janë bartur vit pas viti në shumë prej 120.69 €. Në kategorinë paga dhe mëditje shpenzimi është në shumë prej 554,498.84 € apo 25.75 %, në kategorinë mallra dhe shërbime shpenzimi është në shumë prej 98,504.12 € apo 18.75%, në kategorinë ekonomike shërbime komunale shpenzimi është në shumë prej 17,969.68 € apo 19.22 %, në kategorinë ekonomike subvencione dhe transfere shpenzimi është në shumë prej 6,109.00 € apo 5.41 %, në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale shpenzime nuk ka pasur. Totali i shpenzimit për periudhën Janar -Mars të vitit 2024 është në shumë prej 678,081.64 € apo 17.79 %. Projeksioni i të hyrave vetanake për vitin 2024 është në shumë prej 274,376.00 € . Komuna e Hanit të Elezit ka arritur të arkëtojë 111,374.83 € të hyra vetanake për periudhën Janar - Mars 2024 apo 40.5 % e planit të të hyrave vetanake , ndërsa në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2023 kemi një rritje më shumë prej 67,625.54 € apo 87.18 %. Në raport i keni të gjitha të sqaruara në mënyrë të detajuar.

**Sherif Berisha** thekson:-planifikimin e të hyrave vetanake nga katërqind mijë e keni zvogëluar në dyqind e shtatëdhjetë mijë dhe tani potenconi që keni realizuar 40 % të të hyrave pra ju a keni planifikuar më pak që realizimi të jetë sa më u arritur. Gjatë këtij tre mujori keni potencuar që është alokuar buxheti por me sa kam njohuri buxheti alokohet çdo tre muaj nga 25 % dhe kërkoj sqarime pse është bërë në këtë formë. Shuma prej pesëdhjetë e tre mijë euro e pagesave të vendimeve gjyqësore kërkoj sqarim se për cilat pagesa bëhet fjalë . Te kategoria mallra dhe shërbime janë kryer pagesat përmbartimore për arsim në shumë mbi gjashtë mijë euro por për çfarë pagesa bëhet fjalë. Te kategoria ekonomike shpenzime komunale janë kryer pagesat përmbartimore në shumë prej mbi gjashtë mijë euro pra kërkoj sqarim se për cilat pagesa bëhet fjalë. Si mundet nga shpenzimet komunale të kryhen pagesat e arsimit apo prej mallrave dhe shërbimeve.

**Lindita Ballazhi** thekson:- sa i përket planifikimit apo projeksionit të të hyrave vetanake kur të bëhet planifikimi i të hyrave vetnake merren për bazë disa çështje të ndryshme dhe ju jeni dëshmitarë vetë që e keni votuar vendimin për faljen e tatimit në pronë deri në njëqind euro që do të thotë llogaritë e artueshme kanë rënë dukshëm dhe është zvogëluar projeksioni për inkasimin e të hyrave vetanake duke u bazuar në fakte reale se sa ne mundemi si komunë t'i inkasojmë . Disa shërbime të tjera që kryhen nga administrate komunale mund të gjenerohen nga Ekososva kështu që qytetarët mund t'i marrin falas ato certifikata. Në tre mujorin e parë janë inkasuar 40.5 % e të hyrave vetanake . Në këtë buxhet unë potencova se çka është alokuar për çdo muaj për çdo drejtori që e ka në plan të punës. Pagesat gjyqësore kanë të bëjnë me sektorin e arsimit të cilat janë për diferencën e kualifikimeve dhe këto janë marr nga përmbartuesit , kështu që neve thesari vetëm na ka njoftuar që nga këto kategori të caktuara është bërë marrja e mjeteve.

**Resul Suma** thekson:- raporti është mirë i përpiluar por te shpenzimet kapitale është zero, a është që ka nisur zotimi i mjeteve për kontratën kolektive dhe sa mjete financiare do të shpenzohen për kontratën kolektive për mësimdhënësit.



**Lindita Ballazhi** thekson:-shpenzimi është zero por janë kryer disa punë që janë nga viti i kaluar që drejtoria e urbanizmit ka më shumë informacione, ndërsa për këtë vit do të zhvillojmë procedura të prokurimit dhe do të punojmë. Për shumën e mjeteve financiare nuk kam ndonjë shumë të saktë sepse për këtë është zyrtari ligjorë.

**Zaim Bela** thekson:- bursat e studentëve a open prej subvencioneve apo ende nuk janë dhënë dhe nuk janë përfshirë në këtë raport.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- subvencionet tash janë shpërndarë ndërsa raporti është për periudhën janar –mars dhe pastaj në tre mujorin e dytë përfshihet pasqyra financiare . Çështjen e kontratës kolektive e kemi diskutuar edhe më herë por edhe me komuna që do të jetë problem për realizimin e projekteve të cilat i kemi planifikuar nga viti i kaluar .

**Ajnure Thaçi** thekson:- te shpenzimet kapitale te pika 3.9 shohë që është një shpenzim në shumë prej 2540 €, kërkoj sqarim .

**Lindita Ballazhi** thekson:- shpenzimi te kategoria investimeve kapitale për tre mujorin e parë është zero , ndërsa për vitin paraprakë kjo shumë ka të bëjë për shpronësimin e një parcele.

**Refet Kalisi** thekson:- të hyrat vetanake në krahasim me vitin e kaluar është një shumë prej 67 000 € që është pozitive , mirëpo çka ka ndikuar te të hyrat vetanake që është ky ndryshim.

**Lindita Ballazhi** thekson:-te ky inkasim më i lartë në krahasim me vitin e kaluar ka të bëjë pagesa e taksës komunale për ushtrim të veprimtarisë nga kompania Sharrcem.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

#### **4. Informatë për ndarjen e bursave.**

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Hisni Luri** thekson:- duke u bazuar në rregulloren për ndarjen e subvencioneve komisioni për ndarjen e bursave ka bërë përzgjedhjen e aplikantëve. Nga thirrja të cilën e kemi shpallur kemi pasur 63 aplikime . studentët të cilët kanë qenë përfitues sipas plotësimit të kushteve dhe kriterëve kanë qenë nga viti i dytë e më lartë. Studentët të cilët studiojnë në Universitetin e Maqedonisë së veriut janë tetë që janë përfitues që studiojnë në fakultet të mjekësisë pra gjithsejtë janë 40 studentë që kanë përftuar bursë.

**Malik Berisha** thekson:- këto njëzet e tre që kanë mbetur a keni biseduar me bizneset që me ju bërë ndonjë zgjidhje.

**Hisni Luri** thekson:- njëzet kanë qenë nga viti i parë dhe tre studentë do të përfshihen prej donatorëve por është e pamundur që njëzet biznese me i ngarkuar për me i subvencionuar.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.



#### 4. Raporti financiar për periudhën Janar – Mars 2024 i N.P.L “Pastrimi” sh.a.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Sherif Berisha** thekson:- sa ekonomi familjare i kemi që nuk kanë bërë kontratë dhe në raport figuron një borxh dhe a ka forma për me i alokuar këto mjete.

**Refet Kalisi** thekson:- e lexova raportin dhe më erdh mirë që në këtë periudhë është një fitim prej 19 447 € pra është pozitive dhe është në rritje me tre mujorët e tjerë. Për bordin e kompanisë sa mjete financiare shpenzohen dhe është mirë me shënuar se sa paguhet një anëtarë i bordit .

**Mehmet Ballazhi** thekson:- z. Sherif Berisha je në komision të aksionarëve dhe mundesh informacione me marr më shumë. Rritja që është bërë në vitin e kaluar është për kontrata për shërbime që i kanë dhe që është bërë ngritja e çmimit ka ndikuar që të rritet. Po ashtu ka ndikuar edhe inkasimi i borxheve të grumbulluara.

**Sherif Berisha** thekson:-si komision i kuvendit kemi bërë shkresë te zyra ligjore për çështje të pagesës por ende nuk kemi marr përgjigje.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- kompania NPL Pastrimi i ka politikat të cilat i zhvillon, e ka një pasqyrë financiare dhe i kanë planifikimet pa ndonjë ndikim të institucionit pavarësisht që është aset i komunës por ne paguajmë shërbime. Për kërkesën për te zyra ligjore nuk kam informacione.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

#### 5. Të ndryshme.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Resul Suma** thekson:- janë dhënë 84 serra por pjesa e sipërme ende nuk ka ardhur a vjen këto ditë sepse ka kërkesa prej përfituesve që ka shkuar pakë vonë. Për çështjen e ujit shohë që është duke u punuar aq sa ka mundësi, a keni mundësi si kryetarë i komunës me kërkuar raport nga Bifurkacioni sa kyçje janë ilegale, sa kyçje janë sanuar, a është dënuar dikush për këto kyçje ilegale, a ka ende shtëpi që nuk janë këqyr me orëmatës nga Bifurkacioni.

**Abduraman Bushi** thekson:- është vonuar pak për shkak se kanë qenë tu i vendosur edhe në komuna të tjera po ashtu edhe koha ka qenë e keçe dhe nga dita e ejte do të fillon montimi për shkak se nga e ejtja deri sot nuk ka mundur me i nxjerr folitë nga dogana.

**Mehmet Ballazhi** thekson:-është një angazhim konkretë që e kemi marr për zgjidhjen e procesit të ujit që është i vazhdueshëm dhe kjo që ka ndodhur tash është një punë serioze që e kemi bërë sidomos me dhënien në menaxhim të kompanisë Bifurkacioni dhe bashkëpunimin që e kemi pas me Bifurkacionin kohët e fundit e ka marr shumë seriozisht për shkak se pagesat që bëhen binë në barrën e kompanisë Bifurkacioni dhe komuna i ka ofruar të gjithë kërkesat që i ka pasur kompania Bifurkacioni për me arritur deri te kjo zgjidhje që kryesisht me arritur me eliminuar humbjen apo shkarkimin e pa nevojshëm të ujit nga fabrika direkt në kanalizim dhe kjo ka qenë ndryshimi i madh që ka ndodhur të premtën pas dite dhe është eliminuar. Kyçje ilegale ka por është një fazë tjetër e këtij procesi pra komplet procesi i ka disa faza që ka me vazhduar edhe më tutje por ende nuk kemi ardhur në fazën e inspektoratit siç e kanë potencuar menaxherët e kompanisë Bifurkacioni. Me numër të saktë nuk e di numrin e konsumatorëve që nuk janë këqyr por mund të jetë deri në pesëdhjetë numri i atyre që nuk janë këqyr. Hulumtimet për humbje të ujit janë tu vazhduar përmes aparateve që i ka kompania për me i gjetur humbjet e ujit. Ndryshimi që ka ndodhur të premtën ka shkaktuar dëmtim të gypave e që na po mundohemi me i sanuar brenda mundësive që i kemi.



**Xhevahir Dernjani** thekson:- është rritur numri i studentëve që kanë përfituar bursa që është një ndihmesë për ato që e kanë merituar . Drejtorja e shërbimeve publike i ka vendosur shportat e mbeturinave po ashtu edhe nëpër udhëkryqe i ka vendosur pasqyrat që janë me standarde që ja vlejné si komunitet ku jetojmë. Me datë 03.05.2024 do të mbahen zgjedhjet për administratorë të qytetit dhe bëjë apel nga kuvendi që të marrin pjesë qytetarët në mënyrë që ta zgjedhin më të mirin.

**Sherif Berisha** thekson:-shefi i mjekësisë familjare nga kush zgjidhet. A po vazhdojnë të ipen shujtat për mësimdhënësit. Kërkoj sqarim për profesorin z.Arben Morina i cili është në shkollë të mesme i cili ka marr pushim mjekësorë ose pa pagesë dhe jep mësim në Maqedoni.

**Nora Xhoni** thekson:-a ka mundësi ne si këshilltarë komunal me pasur një takim me përfaqësuesit e Bifurkacionit për çështjen e ujit me diskutuar. Kërkoj që shportat e mbeturinave të vendosen edhe ka lagjja e Re e sidomos te ajo pjesa e gjelbëruar te marketi Jona.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- si ekzekutiv ja përcjelli por obligim nuk e kanë sepse kompanitë janë në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë por shqetësimet e juaja dhe qytetarëve vazhdimisht ua kemi përcjell.

**Hanumshahe Dibrani** thekson:- dua ta paraqesë çështjen e diskriminimi gjinorë tek rrugët e Hanit të Elezit që janë bërë sipas emrave të dëshmorëve ngjarjeve historike apo personave që kanë bërë për komunën ose për Kosovën në përgjithësi . Një dukuri e cila vërehet në këto rrugë është se asnjë rrugë nuk është emërtuar me emër të ndonjë personi të gjinisë femërore dhe kjo përveç se paraqet rast diskriminimi paraqet edhe përulje para veprave të një gruaje. Veprat e Nën Terezës , Ganimete Tërbeshit dhe të tjerave nuk duhet të nënvlerësuar por duhet çmuar dhe renditur lartë sepse mandej kjo inspiron vajzat e reja tek ndryshimi në këtë çështje

**Kryesuesi** thekson:- ke qenë asambleiste kur është bërë emërimi i rrugëve dhe pse po shkoni aq lartë te emrat kur kemi emra edhe këtu si Hafe Fida që ja vlen me emërtuar një rrugë dikunë.

**Arsim Dernjani** thekson:- aq kemi pasur buxhet dhe e kemi bërë vetëm qendrën por jemi duke pritur një donacin dhe nëse aprovet do të bëhet për të gjitha fshatrat.

**Hisni Luri** thekson:- sa i përket shujtave në vitin 2023 e kemi pasur një kod buxhetorë prej Ministrisë që ka qenë e planifikuar për shujtat e fëmijëve dhe ne e kemi zbatuar por shuma e mjeteve të cilat kanë qenë të ndara prej Ministrisë për këtë çështje janë shpenzuar dhe në momentin që na subvencionon Ministria përsëri do të fillojmë shujtat për fëmijë. Sa i përket profesorit që u përmendë afër shtatë muaj ka që ka kërkuar pezullim prej vendit të punës dhe nuk paguhet.

**Kimete Kuka –Hasallari** thekson:- sa i përket shefave të sektorit me hyrje në fuqi të ligjit të ri këto shefa përcaktohen me konkurs të brendshëm brenda institucionit.

**Ajnure Thaçi** thekson:-çfarë marrëveshje është bërë me organizatën Toka. Si është duke shkuar ecuria e popullsisë dhe a keni ndonjë shifër zyrtare deri më tani.

**Hisni Luri** thekson:-është bërë marrëveshje për me bërë trajnime për mësimdhënësit për mësimdhënie praktike, ka të bëjë me vullnetarizmin e studentëve dhe qytetarëve aktiv.

**Mehmet Ballazhi** thekson:-përmes videove jam mundur me bërë thirrje publike që me i vetëdijësuar qytetarët për shkak se është një obligim ligjorë për me bërë regjistrimin dhe i ftojë që të regjistrohen ku e kanë vendqëndrimin. Ecuria e regjistrimit nuk është keq por është mirë dhe brenda ditëve të fundit ka shuar jashtëzakonisht mirë.



**Erblin Meliqi** thekson:-ju falënderoj për përmbushjen e kërkesave të disa qytetarëve që njëra prej tyre ka qenë sinjalizimi dhe vendosja e pasqyrave rrugore dhe bëjë thirrje te qytetarët që ti ruaj se janë në të mirën e tyre. Drejtorit të Urbanizmit i bëjë thirrje për zonën që kemi biseduar për me rehabilituar që nga dita e nesërme mundemi me dal për me shikuar.

**Refet Kalisi** thekson:- te parku “Isa Berisha” drunjët dekorativ që kanë dështuar është mirë me iniciuar procedurë për me i zëvendësuar . Sa ekonomi familjare kanë bërë legalizimin e shtëpive dhe sa kërkesa ka për legalizim

**Resul Suma** thekson:- a ka pasur interesim prej qytetarëve për grante për shkak se është shtyerë afati.

**Majlinda Kaloshi** thekson:-është hera e parë që prej drejtorisë për zhvillim ekonomik mbështetën bizneset fillestare dhe ekzistuese të vogla dhe interesi ka qenë shumë i madhe dhe kjo ka qenë arsyeja që e kemi vazhduar afatin e aplikimit.

**Hanumshahe Dibrani** thekson:-ndriçimi te rruga “Imer Vila” disa drita nuk janë në funksion. Zebrat te Ura e Seçishtë dhe te marketi Jona kur do të vendosën.

**Arsim Dernjani** thekson:- janë tu zhvilluar punimet edhe për zebrat edhe për ndriçimin publik.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- në parkun “Isa Berisha” kanë dështuar disa pemë dhe e kam takuar pronarin e kompanisë punë kryese dhe kam kërkuar që me i ndërruar por pronari ka potencuar që është problem me i gjet në treg. Është kryer projekti i pjesës së vrashtë te shkolla e mesme Dardania përmes OJQ Toka.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen.

Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 12:29.

**Procesmbajtësi**  
**Ayni Bushi**

